

**KËRKESE PËR OFERTË**  
*Procedura për kuotimin e çmimeve*

<b>Numri kërkesës për ofertim:</b>	ICK-CLF-2020/032
<b>Data e publikimit</b>	22 Maj 2020
<b>Data e mbylljes:</b>	02 Qershor 2020
<b>Titulli i kontratës:</b>	RISHPALLJE - Trajnim Profesional në Social Media Management
<b>Autoriteti Kontraktues</b>	Innovation Centre Kosovo, ICK
<b>Adresa:</b>	Rr. Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë, RKS
<b>E-mail:</b>	info@ickosovo.com

## PËRMBLEDHJE

Innovation Centre Kosovo (ICK) fton subjektet (persona fizik apo juridik) e interesuara të paraqesin ofertat për:

- RISHPALLJE - Trajnim Profesional në Social Media Management.

Kompanitë/ligjëruesit duhet të ofertojnë sipas kërkesës të paraqitur në këtë dokument dhe termave të referencës të bashkangjitur.

## KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë/ligjëruesit e interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim,
- Duhet të shënohet data e ofertës,
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 60 ditë),
- Programin, metodologjinë, kurrikulën e detajuar të trajnimit / trajnimeve si dhe numrin e orëve (një orë e trajnimit = 60 minuta),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së ( të gjitha në kopje),
- Për ligjëruesit duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit,
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe në të duhet të ceket çmimi për orë (me të gjitha taksat) si dhe totali,
- Jepni një përshkrim të shkurtër të kompanisë / institucionit tuaj, listën e trajnimeve aktuale,
- certifikimet të cilat i keni / posedon kompania juaj, si dhe përvoja dhe kualifikimi i kompanisë / ligjëruesit, për shërbime të zhvillimit të trajnimeve.
- Duhet të ofrohen referencat mbi shërbime të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (maximum 3 referenca), si dhe CV-të e Ligjëruesit/ve Profesional që do të mbajë trajnimin,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze, Oferta duhet të dorëzohet përmes email-it në info@ickosovo.com. Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 02 Qershor 2020, ora 12:00.

**\*SHËNIM ME RËNDËSI:**

- i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania fituese duhet të prezantoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.
- iii) Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

**KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT**

- Oferta e kompletuar duhet të dorëzohet/dërgohet përmes email-it në [info@ickosovo.com](mailto:info@ickosovo.com)
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 02 Qershor 2020, ora 12:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: [info@ickosovo.com](mailto:info@ickosovo.com). Pyetjet pranohen deri më 28 Maj 2020.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 02 Qershor 2020 ora 14:00 nga Komisioni përzgjedhës (i përbërë nga 3 anëtarë) dhe të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të jenë prezent gjatë hapjes në video-konferencë (kërkesa duhet të shtrohet gjatë aplikimit).
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	
1.1. Programi, metodologjia dhe kurrikula propozuar	40%
1.2. Përgatitja, historiku dhe përvoja e Ligjëruesit/ve të propozuar	10%
1.3. Referenca me detaje të kontaktit (max 3 referenca)	10%
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	40%
<b>Total:</b>	<b>100%</b>